

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ENER TRADE” SHPK

Në Tiranë, sot, më datë 12/09/2018, ortakët si më poshtë:

- 1. Marin Gjonaj**, i biri i Besnik, shtetas shqiptar, lindur më 30.08.1985 në Tiranë, Shqipëri dhe banues në adresën: Rruga “Nikolla Lena”, nr. 42, Tiranë, identifikuar nga Pasaporta me nr. BR9864209, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;
- 2. Artur Mickaj**, i biri i Arben, shtetas shqiptar, lindur më 01.05.1986 në Tiranë, Shqipëri dhe banues në në adresën: Rruga “Jan Kukuzeli”, Pall. 1, Ap. 24, identifikuar nga Leternjoftimi me nr. I60501028T, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;

Vendosën të hartojnë këtë Akt Themelimi, me përbajtje si më poshtë:

NENI 1
DATA E THEMELIMIT


Sot, më datë 12/09/2018, themeluesit Marin Gjonaj dhe Artur Mickaj vendosën të krijojnë një shoqëri me emërtimin “ENER TRADE” SHPK.

NENI 2
FORMA E SHOQËRISË

Kjo shoqëri do të jetë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

NENI 3
EMËRTIMI

Emri i plotë i shoqërisë është “ENER TRADE” SHPK.



NENI 4
SELIA

Selia e Shoqerise ndodhet në adresën: Tiranë, Njësia Administrative Nr. 7, Rruga "Muhamet Gjollesha", Pallati "Nord Konstruksion", pranë Tirana Ring Center, Kati V, Ap. 46.

Me miratim te organeve të saj, shoqëria mund të ndryshojë selinë. Mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

NENI 5
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim te Asamblesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë, ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

NENI 6
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria "ENER TRADE" SHPK do të ketë si objekt të veprimtarisë:

Veprimtari në sektorin e energjisë elektrike. Import, eksport, tregtim të energjisë elektrike. Shitje dhe blerje të energjisë elektrike brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Çdo aktivitet tjeter tregtar që lidhet në mënyre të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 7
KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100 000 (njëqind mijë) Lekë, i zotëruar plotësisht nga ortakët si më poshtë:

Emri	Perqindja %	Kuota (pjesë)	Vlera e pjesmarrjes
Marin Gjonaj	50 %	1	50 000 (pesëdhjetë mijë lekë)
Artur Mickaj	50 %	1	50 000 (pesëdhjetë mijë lekë)

Ky kapital është i ndarë në 2 (dy) kuota të zotëruara nga dy ortakët.
Kapitali themeltar do të depozitohet ne një Bankë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.

NENI 8
ADMINISTRATORI

Administratori i parë i shoqërisë “ENER TRADE” shpk do të jetë:

Z. Artur Mickaj, i biri i Arben, shtetas shqiptar, lindur më 01.05.1986 në Tiranë, Shqipëri dhe banues në adresën: Rruga “Jan Kukuzeli”, Pall. 1, Ap. 24, identifikuar nga Letërnjoftimi me nr. 160501028T, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Kohëzgjatja e mandatit të tij është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9
DISPOZITA E FUNDIT

Ky akt themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore.

Të dhënat tregtare të detyrueshme si dhe të dhënat e tjera për shoqërinë e sapokrijuar gjenden të detajuara në Statutin e shoqërisë bashkangjitur.

Autorizohet Administratori Artur Mickaj ose cdo përfaqësues i posaçëm i caktuar prej tij për të kryer veprimet e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

THEMELUESIT

Marin GJONAJ



Artur MICKAJ
